



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministarstvo Životne Sredine i Prostornog Planiranja
Ministry of Environment and Spatial Planning
Departamenti i Mbrojtjes së Mjedisit/ Departament za Životnu Sredinu/
Department of Environment Protection

DATË/A:	19.08.2026
REFERENC-Ë:	26/3688-566/DMM
PËR/ZA/TO:	"Monuni" Sh.p.k. Gjilan
CC:	
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Z. Bajram Kafexholli, U.D. i Sekretarit të Përgjithshëm të MMPH-së Znj.Miradije Gërguri,U.D. Drejtore e DMM-së Z. Rizah Muçolli, Udhëheqës i DLLM-së
NGA/OD/FROM:	Përparim Terziu, Zyrtar i Lartë i angazhuar për Biocide
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Përgjigje në kërkesën për leje importi për produkte biocide

Të nderuar/a,

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, ka shqyrtuar kërkesën me Nr.Prot.3688/26, datë:30.06.2026 për import të Produkteve Biocide për kompaninë "Monuni " Sh.p.k. Gjilan, dhe ka vendosur si në Vendimin e bashkëngjitur:

Me respekt!



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministarstvo Životne Sredine i Prostornog Planiranja
Ministry of Environment and Spatial Planning

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

Nr.: 26/3688/MMPH
Datë: 19.08.2026

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, në mbështetje të nenit 18 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 7/01 Mars 2019), shtojcës 1 pika 10 të Rregullores (QRK) Nr. 14/2023 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, nenit 27 paragrafi 1 dhe nenit 43 të Ligjit Nr. 08/L-065 për Produktet Biocide, si dhe nenit 39 të Ligjit Nr. 08/L-116 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-197 për Kimikate nxjerr:

V E N D I M

Aprovohet kërkesa me Nr.Prot.3688/26, datë 30.06.2026 për import të Produkteve Biocide për kompaninë "Monuni " Sh.p.k. Gjilan.

Lista e produkteve biocide që do të importohen të shënuara në tabelën e mëposhtme, substanca aktive e produkteve në fjalë është aktive, pas verifikimit në ueb faqen e Agjencisë Evropiane e Kimikateve (ECHA - European Chemicals Agency)

Substanca aktive	Produkti	Sasia / forma	Nr. i notifikimit	Cas Numër	Lloji i produktit biocid (PT)
Permethrin	Pancid koncentrat 100 mlprotiv gmizuçih,leteçi ins.i krpelja	600 copa	5412/3688/26/K OS	52645-53-1	Insekticid

Alfa cipermethrin	Pancid plus 50 ml	3000 copa	5413/3688/26/K OS	67375-30-8	Insekticid
Alfa cipermethrin	Pancid plus 10 ml	1980 copa	5414/3688/26/K OS	67375-30-8	Insekticid
Alfa cipermethrin	Osatox protiv osa i muva 10 ml	600 copa	5415/3688/26/K OS	67375-30-8	Insekticid

Produktet biocide nga tabela e më sipërme duhet të menaxhohen sipas kushteve të parapara në Listat përkatëse Teknike të Sigurisë për Kimikate (Safety Data Sheet). Kompania në fjalë është e obliguar të bëjë transportimin e produkteve biocide duke iu përmbajtur kushteve të ADR.

Ndërsa, nuk aprovohet kërkesa për import për substancën aktive: Trihoroizocijanurna kiselina trehlor me Cas- 87-90-1, pasi që e njëjta nuk hynë në grupin e produkteve biocide

Kompania në fjalë, është e obliguar ta njoftoj MMPH me shkrim, pas çdo realizimi të importit produkteve biocide në sasinë e lejuar për të cilën lëshohet Leja.

Leja për Import për produkte biocide lëshohet për periudhën 1 (një) vjeçare.

Ar sy e t i m


Pas shqyrtimit të kërkesës për Leje Importi për Produkteve Biocide të kompanisë "Monuni" Sh.p.k. Gjilan, me nr. biznesit 811431238, Zyrtar i Lartë i angazhuar për shqyrtimin e kërkesës për leje importi për Produkte biocide, konstatoi se pala i plotëson kriteret e parapara në nenin 29 të Ligjit Nr. 08/L-065 për Produktet Biocide, nenin 38 dhe 39 të Ligjit Nr. 04/L-197 për Kimikate dhe nenin 38 të Ligjit Nr. 08/L-116 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-197 për Kimikate, .

Substanca aktive e produktit në fjalë është aktive sipas ECHA .

Pala është e obliguar të paguaj taksën administrative në vlerë prej dhjetë (10) euro për marrjen e Lejes për import për produkte biocide siç parashihet në paragrafin 1 të nenit 41 të Ligji Nr. 08/L-116 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-197 për Kimikate.

Substanca aktive sipas deklaratës të operatorit përdoren për:

1. Permethrin- si substancë është insekticid, qëllimi është për shitje të mëturjeshme
Prodhuar në Savacoop DOO -Novi Sad, Shteti, Serbi .



2. Alfa cipermethrin - si substancë është insekticid ,qëllimi është për shitje të më tutjeshme Prodhuar ne Savacoop DOO -Novi Sad, Shteti, Serbi.

Ndërsa, nuk aprovohet kërkesa për import për substancën aktive: Trihoroizocijanurna kiselina trehlor me Cas- 87-90-1, pasi që e njëjta nuk hynë ne grupin e produkteve biocide

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të parashtroj ankesë në afat 30 ditë nga marrjes së këtij vendimi në Komisionin e ankesave për shqyrtimin e vendimeve lidhur me lejet në Ministri.

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor

Nr.: 26/3688/ZSP/ /26 datë: 19.08.2026

Bajram Kafexholli

U.D. i Sekretarit të Përgjithshëm i MMPH-së

Vendimi t'iu dërgohet:

- Parashtruesit të kërkesës;
- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;
- DMM-së;
- Divizionit për Leje dhe Licenca Mjedisore;
- AMMK-së;
- Inspektoratit të MMPH-së;
- Kabinetit të Ministrit;
- Zyrës për komunikim me Publik të MMPH-së;
- Arkivit të MMPH-së